REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

Nr. 130341/1 Prot. Tiranë, më 10/07/2020

UDHËZIM PLOTËSUES

Nr. 27 Datë 10/07/2020

"PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM VENDOR 2021-2023"

Në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", Ministri i Financave dhe Ekonomisë:

U D H Ë Z O N :

Ky udhëzim përmban:

I. Afatet për përgatitjen dhe miratimin e tavaneve përfundimtare të përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023;
II. Transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
III. Proceset për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023;
IV. Ndjekja e Procesit dhe Mbështetja Këshillimore
V. Të tjera

I. Afatet për përgatitjen dhe miratimin e tavaneve përfundimtare të përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023

1. Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.
2. Raporti i vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve përmban të dhënat për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor dhe tre vitet e ardhshme buxhetore.
3. Në këtë raport përfshihet:
   a) metodologjia e përdorur për parashikimin;
   b) analiza e efekteve të politikave të reja fiskale ose ndryshimit të atyre ekzistuese; dhe
   c) analiza e risqeve dhe masave për përballimin e tyre.